Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0891

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani si paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE "AS Tech " Sh.P.K., Prishtinë, kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së" me nr. të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës, më 12/01/2024, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE " AS Tech " SH.P.K. me nr. 2023/0891, e datës 10/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit 214-23-6032-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës, ndërsa mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 23.10.2023

II. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.06.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me klima për objektet e PK-se" me nr. të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1. Ndërsa me datën 23.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Kiga" Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 58,500.00 €.

Me 30.10.2023, OE "AS Tech " Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 31.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim, me arsyetimin se AK sipas vendimit të OSHP me numër 2023/0614 të datës 06.10.2023 ka bërë rivlerësimin e ofertave dhe sipas rekomandimit të vendimit AK ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për të sqaruar modelin e ofruar dhe ri konfirmim të specifikave teknike të modelit, OE ka dërguar sqarimet e kërkuara duke definuar saktë modelin e ofruar dhe të gjitha parametrat e kërkuara si llojin e gazit, energjisë dhe të tjera mbi këtë bazë OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm pasi i plotëson specifikat teknike te kërkuara nga ana e AK. Si dhe AK ka sqaruar se oferta e OE ankues është e pa përgjegjshme këtë e vërteton edhe vendimi me numër 2023/0614 të datës 06.10.2023 ku OE ankues herën i parë i janë kërkuar sqarime mirëpo në bazë të përgjigjeve dhe sqarimeve te dërguar oferta e juaj është e papërgjegjshme.

Me 10.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AS Tech " Sh.P.K. me nr. 891/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me klima për objektet e PK-se" me nr. të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech " Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) Ankuesi pretendon se "AK ne procesin e rivlerësimit e shpërblen përsëri OE e njëjte Kiga, edhe pse edhe ne Vendimin e pare te AK-se dhe ankesën e dorëzuar ne OSHP për atë vendim ky OE ishte i papërgjegjshëm. Pretendimi ynë lidhur me ofertën e OE Kiga ishte qe ka ofertuar me dy modele ndonëse nuk lejohet me ligj një gjë e tillë. Ne procesin e rivlerësimit ju keni kërkuar sqarime qe OE te specifikoj brendinë qe oferton, dhe specifikat e tij , por OE ka sjell një dokument jo te pranueshëm. OE ne përgjigje te letrës standarde nuk ka dhëne asnjë deklarate por vetëm ka dorëzuar një dokument nga Distributori për Kosove i një brendi Rimida qe ai e ka dhëne për OE Kiga, por qe askund nuk ceket emri i projektit ne fjale apo numri i prokurimit. Ky dokument nuk mund te jete aspak i pranueshëm sepse nuk është i lëshuar nga OE te cilit i është bere kërkesa përmes letrës standarde. Nuk shkruan askund Deklarate qe OE te deklaron për modelin qe oferton, por është thjeshte një dokument i lëshuar nga një pale e trete

për palën e dyte, qe ne ketë rast është OE Kiga. Përfundimisht OE nuk ju ka përgjigjur AK-se siç AK e ka parashtruar kërkesën dhe rrjedhimisht oferta e tij është e papërgjegjshme sepse OE nuk ka dhënë asnjë Deklarate se deklarohet me vule dhe nënshkrim te tij për modelin qe oferton. Ndonëse përsëri e shohim kontestuese mundësinë qe AK i ka dhen OE për te zgjedhur modelin, kur ligji askund nuk e jep një mundësi te tillë. OE ne oferte te tij ka ofertuar me variante dhe kjo nuk është e lejuar me ligj te prokurimit publik, Neni 29 -Variantet e specifikimeve teknike- 3. Autoritetet kontraktuese që autorizojnë variantet duhet të deklarojnë në dosjen e tenderit kërkesat minimale për tu plotësuar nga variantet dhe ndonjë kërkesë specifike për prezantimin e tyre. AK askund ne dosje nuk e ka specifikuar se variantet pranohen, dhe as ne proces te vlerësimit nuk është dashur te trajnohet mundësia e sqarimeve sepse OE brenda ofertës ka ofertuar me dy modele, ne foto te katallogut ka një model tjetër ndërsa me poshtë katallogt tek specifikat e klimës përkatëse është një model tjetër."

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se: "Ne qasjen qe e kemi pasur ne oferte nuk kemi dëshmi se OE i ka dorëzuar Vetëtimat tatimor apo te gjykatës, prandaj ne kërkese për rishqyrtim kemi kërkuar qe AK te dëshmoj se OE i ka sjell ato para Vendimit te AK-se, AK ne përgjigje te Kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhen përgjigje për ketë pike. Rrjedhimisht Kërkesa jone për rishqyrtim nuk është trajtuar ne ketë pike, pra ne nuk kemi pasur qasje te tërësishme te ofertës se OE te rekomanduar, AK nuk e ka respektuar ne tërësi kërkesën për qasje siç e lejon edhe ligji."

Pretendimi i tretë (III): Ankuesi pretendon se: "AK nuk i ka trajtuar njësoj OE, nga OE Kiga ka kërkuar sqarime ndërsa nuk ka kërkuar sqarime për ofertën tone, përkatësisht për specifikat tona. Konsiderojmë se AK ka bere shkelje te LPP-se duke mos i trajtuar barabarte OE."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "AS Tech " Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 6, 7, 29, 59 dhe 60 të LPP-së. Duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues kthimin e lendes në rivlerësim dhe shpërblim të ofertës me kontratë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14.11.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0891/23, ndërsa me datë 20.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/891 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues duke theksuar "Nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit dhe mënyrën se si është bere ekspertiza. Nuk mund te jete e pranueshme ne asnjë rrethane një deklarate e një pale te trete kur ne realitet AK ka kërkuar deklarate dhe sqarim nga OE qe d m th dokumente te nënshkruar nga vete pala ne aktivitet dhe jo nga ndonjë pale tjetër. është dëshmi irelevante ne kërkesën e AK-se për sqarime. Nëse eksperti na quan pale pa interes neve si OE pjesëmarrës, si mund te jete pale me interes një pale e trete qe ka komunikuar ne dokumente me palën e dyte (OE Kiga). Kjo nuk ka aspak baze ligjore. Kjo ekspertize le për te dëshiruar shume mënyrën se si e ka trajtuar lenden. Ne përsëri mbesim te mendimit se nuk jemi trajtuar njësoj nga AK sepse AK nuk ka pasur informacione te mjaftueshme për specifikimet tona dhe përsëri nuk ka kërkuar sqarime.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AS Tech " Sh.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0891 ka vlerësuar si në vijim:

Fillimisht, Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit nr. 2023/0614, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat, me datë 11.09.2023, ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me nr. 2023/0614, bazuar në të gjeturat gjatë shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, të paraqitura në këtë raport, meqenëse ka pasur mospërputhje dhe paqartësi ndërmjet "Modelit TCL me kodin TAC-12CHSA/XA73I", dhe "Modelit TCL me kodin TAC-12CHSD/XA73I", gjithashtu fakti se gjatë kërkimeve në internet paraqiten specifikime të ndryshme sa i përket këtij modeli, andaj për ta qartësuar më mirë këtë situatë, lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, AK të kërkoi sqarim shtesë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-se. Pra, me qëllim të vlerësimit të tenderit në përputhje me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, i propozon Autoriteti Kontraktues - Policia e Kosovës, të anuloi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, si dhe gjatë ri-vlerësimit lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, AK të kërkon sqarime shtesë ndaj OE te rekomanduar për kontratë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në të gjeturat e paraqitura në raportin e ekspertizës me Nr. 2023/0614, Eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Lidhur me këtë çështje Paneli Shqyrtues ka nxjerr Vendim me Nr. 2023/0614 të datës 06.10.2023. Sipas këtij vendimi, bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, Autoriteti Kontraktues POLICIA E KOSOVËS, ka kthyer lëndën në Ri-vlerësim, si dhe me datë 12.10.2023 përmes Letrës Standarde të kërkesës për sqarimet e tenderëve, në pajtim me nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së ka kërkuar sqarime nga OE "KIGA SHPK" i rekomanduar për kontratë.

Me tutje eksperti shqyrtues sqaron se me datë 12.10.2023 përmes Letrës Standarde të kërkesës për sqarimet e tenderëve, në pajtim me nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së ka kërkuar sqarime nga OE "KIGA SHPK" i rekomanduar për kontratë. Lidhur me këtë, AK ka kërkuar sqarime si në vijim: "Definoni modelin e ofruar saktë duke shkruar kodin e modelit te ofruar, te na ofroni sqarime ne lidhje me gazin qe e përdor ky model i klimës, klasën e energjisë elektrike". (prove: Letra standard e kërkesës për sqarimin e tenderit). OE "KIGA SHPK" i rekomanduar për kontratë, sipas kërkesës së AK-së ka ofruar Deklaratë për sqarimin e katalogut për specifikat e klimës, "Modeli me kodin TAC-12CHSD/XA73I", pra katalogu i klimës i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, me përshkrim detal e cila është konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikave teknike te Aneksi 1 i dosjes. Eksperti shqyrtues sqaron se, pas Ri-vlerësimit të ofertave, AK me datë 23.10.2023 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke rekomanduar për kontratë OE "KIGA SHPK", Ndërsa, OE-" AS Tech " SH.P.K, me datë 30.30.2023 kundër vendimit të AK-së ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, ndërsa, AK me datë 31.10.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 10.11.2023 OE- " AS Tech " SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së. Sa i përket pretendimit ankimor Nr.2 të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë, lidhur me "Vërtetimet tatimor apo te gjykatës", Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, OE i rekomanduar për kontratë sipas kërkesës së AK-së ka dorëzuar Vërtetimet lidhur me nenin 65 të LPP-së. Sa i përket pretendimeve ankimore Nr. 1 dhe 3 të OE ankues, të paraqitura në ankesën Nr. 2023/0891 për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore nuk i ka shqyrtuar për faktin se, të njëjtat pretendime ankimore janë shqyrtuar në lëndën me Nr. 2023/0614.

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e lartë cekura, si dhe bazuar në Vendimin e PSH Nr. 2023/0614 i datës 06.10.2023, OE ankues "AS Tech " SH.P.K, për këtë aktivitet të prokurimit rezulton i papërgjegjshëm. Andaj, marrë parasysh ato që u thanë me lartë, si dhe duke marrë parasysh edhe Njoftimin e OSHP-së të datës 09.02.2023 të publikuar në web faqen e OSHP-së, Eksperti shqyrtues,

Operatorin Ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili përcakton: *"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar."*

Sipas të thënave më sipër argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase njejti nuk kishte argumentuar me asnjë provë/fakt konkret pretendimet e tilla. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë Komisionit profesiona të vlerësimit brenda AK si inicuse e këtij aktiviteti të prokurimit dhe konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me klima për objektet e PK-së" me nr. të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nuk është gjetur ndonjë shkelje mbi të cilat ka pretenduar OE ankues me rastin e parashtrimit te ankesës në OSHP.

Lidhur me këtë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK përmes Letrës Standarde të kërkesës për sqarimet e tenderëve, në pajtim me nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së (konform rekomandimeve të Paneli Shqytues Nr.2023/0614 të datës 06.10.2023) ka kërkuar sqarime nga OE "KIGA SHPK" i rekomanduari për kontratë. Me pas OE "KIGA SHPK" i rekomanduar për kontratë, sipas kërkesës së AK-së ka ofruar Deklaratë për sqarimin e katalogut për specifikat e klimës, ***"Modeli me kodin TAC-12CHSD/XA73I".*** Pra katalogu i klimës i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, me përshkrim detal, sipas Komisionit të vlerësimit profesional të AK dhe ekspertit shqyrtues vlerësohet se është konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikave teknike te Aneksi 1 i dosjes andaj rrjedhimisht nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit të cekura në parashtresën e tij/saj,

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjith ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"* sepse apriori sipas dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar i njëjti ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK dhe është ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Paneli shqyrtues në këtë vendimmarrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I ë vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: